

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatori Ekonomik: MetBat SH.P.K., Malet e Krivoves, 13050, Drenas Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	20.05.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **20.05.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **MetBat SH.P.K.** me adresë në **Drenas**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **ASGJËSIMI I MBETJEVE MEDICINALE DHE I BARNAVE PA AFAT – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-24-2530-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-016-2-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **MetBat SH.P.K.** me adresë në **Drenas**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **ASGJËSIMI I MBETJEVE MEDICINALE DHE I BARNAVE PA AFAT – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-24-2530-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-016-2-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **15.05.2024**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit, me Numër të prokurimit: **623-24-2530-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-016-2-2-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

A R S Y E T I M

Operatori Ekonomik: **MetBat SH.P.K.** me adresë në **Drenas**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **ASGJËSIMI I MBETJEVE MEDICINALE DHE I BARNAVE PA AFAT – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-24-2530-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-016-2-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **15.05.2024**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **20.05.2024**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

Ju sqarojmë se pretendimet e tua ankimor nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit *B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar*, ku kemi cekur:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ju njoftoj se ju si O.E. nuk i keni plotësuar kërkesat minimale sipas Dosjes së tenderit të Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT):

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale:

Kërkesa 3: Operatori Ekonomik duhet te jete i licencuar për grumbullimin dhe asgjësimin e mbeturinave medicinale;

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 3: Licenca për këtë veprimtari e lëshuar nga organet kompetente;

Sqarimet janë si në vijim:

Oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme pasi që nuk e plotëson kërkesën e Dosjes së Tenderit dhe të Njoftimit për kontratë, për faktin se keni ofruar Leje Mjedisore të Integruar të lëshuar mbi bazën e Ligjit nr.03/L-043, për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes, i cili ka për qëllim krijimin e standardeve mjedisore për parandalimin e ndotjes, ndërsa AK-ja, në rastin konkret ka kërkuar Licencë e cila lëshohet mbi bazën e Ligjit nr.04/L-060 për mbeturina, që ka të bëjë me menaxhimin e mbeturinave duke përfshirë edhe ato medicinale. Pra, në rastin konkret AK-ja, ka kërkuar Licencë dhe jo leje mjedisore, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së;

Për këtë qështje është edhe Vendimi i OSHP-së me Nr.: 311/23; Vendimi i OSHP-së me Nr.: 534/22;

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Komuna e Rahovecit